



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Sinjal shpk" të datës 16.05.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 12.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "174 Prodhimi, furnizimi dhe vendosja e numrave te adresave për njësit e banimit në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1843-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHE**t kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Sinjal shpk" të datës 16.05.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 12.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "174 Prodhimi, furnizimi dhe vendosja e numrave te adresave për njësit e banimit në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1843-1-2-1.
- II. **DETYROHE**t autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të ofroj qasje në dokumente për parashtruesin "Sinjal shpk" sipas kërkesës dhe në përputhje me LPP.
- III. **AUTORIZOHE**t autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- IV. **NJOFTOHE**n palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Sinjal shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 16.05.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 12.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "174 Prodhimi, furnizimi dhe vendosja e numrave te adresave për njësit e banimit në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1843-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: *"Percakton qe cdo person ka te drejte te kerkoje dhe te marre qasje ne dokumentet publike pa pasur nevoje te tregojë ndonje interes te vecante. Kjo dispozite ligjore eshte shkelur nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtines ne rastin kur nuk na ka mundesuar qasjen ne dokumente zyrtare te cilen kerkese e kemi bere permes e-mailit fillimisht me date: 13.05.2025 ne e mailin: Manush.Gashi@rks-gov.net, e pastaj edhe tek e-maili: visar.shehu@rks.gov.net ne po te njejten date si dhe ne prokurimi.prishtine@rks-gov.net ne po te njejten date. mirepo ende nuk kemi pranuar asnje pergjigje. Qellimi i kerkeses ka qene verifikimi dhe argumentimi se mostrat jane dorezuar teresisht sipas kerkesave te Dosjes se Tenderit. Megenese ende nuk kemi pranuar ndonje pergjigje direkte e as nuk jemi informuar pse mostrat nuk kane qene sipas kerkesave, ankesa ka te beje me diskualifikim e kompanise tone nga e drejta per t'u shperblyer me kontrate per kryerjen e punimeve per projektin ne fjale. Kerkesa jone si Operator Ekonomik eshte qe Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtines te ktheje lenden ne rishqyrtim dhe te rishikojë mostrat e dorezuara per shkak se ne kemi dorezuar mostrat teresisht sipas kerkesave te Dosjes se Tenderit. dhe me kete ne mendojme se na eshte bere e padrejte e madhe duke mos na dhene as sqarime shtese se pse jemi eliminuar"*.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Nuk keni përmbushur kriteret teknike – Mostrat të kërkuara në dokumentet e tenderit për pozicionin 3, 4, dhe 7.

Sa i përket pretendimit se nuk është lejuar qasje në dokumente, duhet cekur se në platformën eprokurimi nuk është ngarkuar asnjë kërkesë për qasje nga parashtruesi. Pra AK përmes eprokurimit nuk ka pranuar asnjë kërkesë për qasje. Në momentin që parashtruesi apo kushdo tjetër të ngarkoj kërkesën për qasje në platformën eprokurimi, brenda afatit ligjor AK do të ofroj qasje në dokumente sipas LPP në fuqi dhe në përputhje me pikën II të dispozitivit të këtij vendimi. Pra kjo pikë e pretendimit është e pabazuar.

Sa i përket pikës së pretendimit lidhur me mostrat, është gjetur se parashtruesi nuk ka përmbushur kriteret teknike lidhur me mostrat e kërkuara në DT për pozicionin 3, 4, 7.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.05.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.